



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN
"KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.uni-gjilan.net tel: 0280390112

Rektori : Prof.Ass.Dr.Bajram Kosumi

Ref.nr. 01/1141 Gjilan, më 30 / 10 /2015

Në bazë të Nenit 48 dhe 49 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, si dhe nenit 19 të Rregullores për studime themelore të fakulteteve (Edukim,juridik,ekonomik dhe shkenca kompjuterike), Senati i UKZ në mbledhjen e mbajtur më 27.10.2015, mori këtë

V E N D I M

mbi kushtet e regjistrimit të viti vijues për vitin akademik 2015/2016

I.

Studentët e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, mund të regjistrojnë vitin vijues të studimeve në vitin vijues po qe se i plotësojnë këto kushte:

- a) Vitin e dytë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët i kanë fituar 70% të numrit të përgjithshëm të kredive, përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të parë të studimeve.
- b) Vitin e tretë të studimeve mund ta regjistrojnë ata studentë të cilët kanë fituar 50% të numrit të përgjithshëm të kredive , përkatësisht lëndëve mësimore të vitit të dytë të studimeve.

II.

Studentët janë të obliguar që në vitin pasardhës t'i japin paraprakisht provimet e mbetura nga viti paraprak e pastaj të fillojnë dhënien e provimeve në vitin në të cilin janë regjistruar.

Vendimi t'i dërgohet:

- Arkivit të UKZ
- Sekretarit të Përgjithshëm
- Dekanëve të fakulteteve
- Administratës në njësi akademike



REKTORI

Prof.Asoc.Dr.Bajram Kosumi